



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVO
REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA - GOVERNMENT OF KOSOVA


MINISTRIA E ARSIMIT E
SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
KQSHM

MINISTARSTVO OBRAZOVANJA
NAUKE I TEHNOLOGIJE

MINISTRY OF EDUCATION
SCIENCE & TECHNOLOGY
DVSM

TESTI I MATURËS

**GJIMNAZI
GJUHËSOR**



Prishtinë, 23 qershor 2012

Emri dhe mbiemri i nxënësit


Shkolla.....

Udhëzime:

Koha: Keni 180 minuta që t'u përgjigjeni 80 kërkesave (pyetjeve). Koha numërohet prej momentit kur do të filloni t'i zgjidhni kërkesat.

Si të veproni?

1. Plotësojini me kujdes, sipas udhëzimeve, të gjitha kodet (në rreth), për: komunën, shkollën, paralelen, numrin e ditarit. Nëse këto të dhëna nuk i plotësoni saktë, nuk do të mund të nxirret rezultati i testit tuaj.
2. Para se të filloni t'u përgjigjeni pyetjeve, qetësohuni plotësisht, sepse kjo do t'ju ndihmojë.
3. Lexojini me kujdes kërkesat dhe pastaj shënojeni vetëm përgjigjen e saktë, nga 4 mundësitë e dhëna, për të cilën besoni se është e saktë.
4. Fleta e përgjigjeve duhet të plotësohet vetëm me laps të thjeshtë - laps HB.
5. Mbusheni kodin (në rreth) e përgjigjes së saktë me laps të thjeshtë, pa e shkarravitur jashtë. Shih shembullin e mëposhtëm.



6. Kini kujdes që përgjigjen e saktë të një pyetjeje të mos ia vendosni pyetjes tjetër të radhës.
7. Në Fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
8. Përgjigjet e sakta plotësohen njëkohësisht – në Test dhe në Fletën e përgjigjeve.
9. Çdo lloj llogaritjeje mund ta bëni në faqen e fundit të testit, ndërsa në fletën e përgjigjeve nuk bën të shkruani tjetër gjë, përveç përgjigjeve, për të cilat jeni të bindur se janë të sakta.
10. Mos humbni kohë me pyetjet që nuk i dini, sepse koha mund të mos ju mjaftojë për pyetjet e tjera.
11. Përdoreni deri në fund kohën e testimit, në mënyrë që t'u përgjigjeni të gjitha pyetjeve.

GJUHË SHQIPE

Lexoni fragmentin më poshtë dhe përgjigjuni pyetjeve që vijojnë.

Të nderuar Zotërinj,

Të dashur kolegë e studentë,

Jam i gëzuar sinqerisht, thellësisht, që ndodhem prapë midis jush. Mbi propozimin e prof. Idriz Ajetit, që më bëri vjet, në bazë të marrëveshjes midis dy universiteteve tona, brenda pak javësh do të mundohem që të prekim këtu së bashku pikat kryesore nga kjo fushë e hapët edhe aq e pasur jo vetëm me rezultate, po edhe me probleme. Natyrisht shumë hollësi këtu nuk mund t'i zhvillojmë – koha nuk na lejon – kështu që do të ndalemi në disa pika kryesore. Në fund të këtij kursi të përmbledhur, i cili mund të mendojmë se ka titullin kështu: *Hyrje në studimin komparativ të gjuhëve indoevropiane*, do të japim edhe një bibliografi për ata që duan ta vazhdojnë më tej e t'i ndjekin problemet.

1. Cilit auditor i drejtohet fjalimi i mësipërm?

- A. të pranishmëve, mësimdhënësve dhe studentëve
- B. akademikëve, bibliotekarëve dhe studentëve
- C. gjuhëtarëve, kureshtarëve dhe studentëve
- D. të pasurve, kursistëve dhe studentëve

2. Me këta të pranishëm, të cilëve u është drejtuar në këtë ligjëratë, ky autor:

- A. takohet së pari herë
- B. nuk dihet nëse i ka takuar ndonjëherë
- C. ishte takuar edhe më herët
- D. ishte takuar para shumë vitesh

3. Mbështetur në veçoritë e gjuhës së këtij teksti, ky fragment i këtij autori është:

- A. rikujtuar nga vajza e autorit
- B. nxjerrë nga fjalimi i tij
- C. treguar nga një i pranishëm në ligjëratë
- D. rrëfyer nga një student i tij

4. Kursi i ligjëratave që do të mbajë ky autor, trajtojnë probleme të një fushe që është:

- A. E gjerë, e thellë dhe komplekse
- B. E veçantë, paragjyquese, analitike
- C. Karakteristike, e re, e përgjithshme
- D. E vjetër, kundërthënëse, arsimore

5. Mbështetur në të dhënat që ofron teksti mund të kuptojmë se studentëve u drejtohet:

- A. Kasëm Trebeshina
- B. Dritëro Agolli
- C. Eqrem Çabej
- D. Ernest Koliqi

6. Në kursin e ligjëratave të titulluar: *Hyrje në studimin komparativ të gjuhëve indoevropiane*, fjala *komparativ*, zëvendësohet me fjalën:
- A. kodifikues
 - B. karakteristik
 - C. komunikues
 - D. krahasues
7. Në fjalinë: *Natyrisht shumë hollësi këtu nuk mund t'i zhvillojmë – koha nuk na lejon – kështu që do të ndalemi në disa pika kryesore*, shprehja: **koha nuk na lejon**, ka kuptimin e shprehjes:
- A. nuk jemi në kohën e duhur
 - B. nuk na mjafton koha
 - C. nuk mundemi në këtë kohë
 - D. nuk kemi caktuar kohë
8. Nga fjalia... *do të japim edhe një bibliografi për ata që duan ta vazhdojnë më tej e t'i ndjekin problemet*, mund të arrijmë në përfundim se fjala është për dhënien e një bibliografie në fushën e studimit komparativ të gjuhëve indoevropiane, që përfshin botimeve të rëndësishme:
- A. të vetë këtij autori
 - B. të autorëve nga Shqipëria
 - C. të autorëve në gjuhë të ndryshme
 - D. të autorëve nga Kosova
9. Në shprehjen: *nuk mund t'i zhvillojmë*, trajta - **t'i**, është bashkim i:
- A. pjesëzës së lidhore dhe trajtës së shkurtër të vetës së tretë shumës të kallëzores
 - B. trajtës së shkurtër të vetës së parë njëjës të dhanores, me trajtën e shkurtër të vetës së tretë shumës të kallëzores
 - C. njëjës së përemrit lidhor dhe trajtës së shkurtër të vetës së tretë shumës të kallëzores
 - D. trajtës së shkurtër të vetës së tretë njëjës të dhanores, me trajtën e shkurtër të vetës së tretë shumës të kallëzores
10. Nëse në fjalinë: *“Ne japim edhe një bibliografi”*, përdoret **kryefjala në numrin njëjës dhe kallëzuesi i shprehur me folje në kohën e kryer të thjeshtë**, fjalia bën:
- A. Ne jepnim edhe një bibliografi
 - B. Unë jepja edhe një bibliografi
 - C. Ne dhamë edhe një bibliografi
 - D. Unë dhashë edhe një bibliografi

HISTORI

- 11.** Me Zbulimet e mëdha gjeografike qendra e tregtisë evropiane u zhvendos nga Deti Mesdhe në Oqeanin Atlantik. Cilat qytete evropiane pësuan dëme nga kjo zhvendosje rrugëve tregtare?
- A. Londra dhe Parisi
 - B. Madridi dhe Lisbona
 - C. Venediku, dhe Gjenova
 - D. Amsterdami dhe Dablina
- 12.** Për forcimin e cilave ndryshime në shoqërinë evropiane ndikoj Lëvizja e reformacionit?
- A. Forcimin e klasës së lartë dhe shtetit të papës
 - B. Forcimin e klasës së mesme dhe zhvillimin e arsimit
 - C. Forcimin e klasës feudale dhe zhvillimin e artit
 - D. Forcimin e klasës skllavopronare dhe sistemit bankar
- 13.** Çka nënkuptohet me radhitjen e ngjarjeve historike sipas rendit kronologjik?
- A. Radhitjen e ngjarjeve nga më të lashtat deri të më të rejtat
 - B. Radhitjen e ngjarjeve nga më të rejtat deri të më të lashtat
 - C. Radhitjen e ngjarjeve nga më të voglat deri të më të mëdhajat
 - D. Radhitjen e ngjarjeve nga më të mëdhajat deri të më të voglat
- 14.** Ligjet e mbretit Hamurab të Mesopotamisë ishin të ashpra dhe diskriminuese për:
- A. Zezakët
 - B. Feudalët
 - C. Aristokratët
 - D. Sklllevërit
- 15.** Çka realizoi Operacioni luftarak i datës 6 qershor 1944 i njohur me emrin "Overlord" (Zotëruesi)?
- A. Zbarkimin e forcave ruse në Çeçeni
 - B. Sulmin e gjermanëve mbi Rusinë
 - C. Zbarkimin e forcave aleate në Normandi
 - D. Sulmin e gjermanëve mbi Anglinë
- 16.** Janë dhënë pohimet:
- I. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë por në përgjithësi kërkesat e shqiptarëve nuk u përfillën.
- II. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë dhe kërkesat e shqiptarëve u përfillën nga evropianët
- III. Në Konferencën e Paqes në Paris problemi i Shqipërisë u diskutua gjatë por kërkesat e shqiptarëve u përfillën vetëm nga italianët
- Cili nga pohimet e dhëna është i saktë:
- A. Vetëm I
 - B. Vetëm II
 - C. Vetëm III
 - D. I, II dhe III

17. Federata Jugosllave ishte një krijesë artificiale shtetërore e dominuar nga serbët dhe përbehej nga disa republika dhe krahina autonome. Nga sa republika dhe krahina përbehej federata jugosllave?

- A. Nga dy republika dhe gjashtë krahina
- B. Nga pesë republika dhe tri krahina
- C. Nga tri krahina dhe pesë republika
- D. Nga gjashtë republika dhe dy krahina

18. Në Kongresin e Elbasanit (1909) përveç vendimit për hapjen e shkollës pedagogjike cili ishte vendimi tjetër i aprovuar?

- A. Krijimi i një shoqërie qendrore që do të kujdesej për shkolla
- B. Krijimi i Ministrisë së Arsimit që do të kujdesej për shkolla
- C. Krijimi i shkollave të veçanta për vajza
- D. Krijimi i shkollave speciale për fëmijë me të meta

19. Lufat e Parë Botërore pati si shkas:

- A. Kongresin e Berlinit
- B. Krizën Lindore
- C. Atentatin e Sarajevës
- D. Atentatin e Zagrebit

20. Përveç Anglisë cilat shtete gjatë Luftës së parë Botërore bënë pjesë në Bllokun e Antantës?

- A. Perandoria Osmane, Bullgaria, Austria
- B. Franca, Rusia, Italia
- C. Shqipëria, Perandoria Osmane, Hungaria
- D. Maqedonia, Shqipëria, Perandoria Osmane

21. Më 1844 ministri serb Ilija Garashanin shpalli projektin e quajtur "Naçertania" Çka parashihte ky projekt në mes tjerash?

- A. Përfshirjen e trevave shqiptare në kuadër të Serbisë
- B. Përfshirjen e trevave greke në kuadër të Serbisë
- C. Bashkimin e Shqipërisë me Serbinë
- D. Bashkimin e Serbisë me Kroacinë

22. "Për të shqyrtuar problemet politike në Ballkan veçmas ato që nxori Lufta e Parë Ballkanike, gjashtë Fuqitë e Mëdha organizuan Konferencën e cila u drejtua nga ministri Eduard Grej. Problemi më i vështirë që u diskutua në Konferencë ishte caktimi i kufijve të Shqipërisë"

Për cilën Konferencë bëhet fjalë në tekstin e lartëshënuar?

- A. Konferencën e Uashingtonit
- B. Konferencën e Romës
- C. Konferencën e Parisit
- D. Konferencën e Londrës

- 23.** Përveç, Holandës, Belgjikës, Danimarkës dhe Luksemburgut cilat shtete e në vitin 1951 formuan Komitetin Evropian që i parapriu formimit të Bashkimit Evropian?
- Austria Polonia, dhe Sllovakia
 - Franca, Gjermania dhe Italia
 - Greqia, Bullgaria, dhe Hungaria
 - Suedia, Norvegjia, dhe Lituania
- 24.** Me cilin shtet ishte e lidhur fuqishëm Shqipëria në Planin e politikës së jashtme gjatë viteve gjashtëdhjeta të shek XX deri më -1978 ?
- Me Bashkimin Sovjetik
 - Me RSF të Jugosllavisë
 - Me Republikën Popullore të Kinës
 - Me Republikën e Greqisë
- 25.** Në cilin vit doli Gazeta e parë në gjuhën shqipe në Kosovë “Rilindja”
- 1945
 - 1946
 - 1948
 - 1949
- 26.** Cilën nga ngjarjet e historisë antike përshkruan vepra “Iliada” e poetit Homeri?
- Luftën e Peloponezit
 - Luftën e Mikenës
 - Luftën e Trojës
 - Luftën e Kretës
- 27.** Greqi antike ishte e ndarë politikisht dhe secila bashkësi e njerëzve kishte ishte e organizuar në një teritor të vogël që ishte qytet-shtet. Si quhej qyteti- shtet në Greqinë antike
- Oligarkia
 - Polisi
 - Bazileusi
 - Geruzia
- 28.** E gjithë popullsia e Romës antike ndahej në dy grupe të mëdha: patricë dhe plebejë. Cilës shtresë i takonin plebejt?
- Shtresës së ultë që nuk kishte të drejta politike
 - Shtresës së ultë që drejtonte tregëtinë
 - Shtresës së lartë që kishte të drejta politike
 - Shtresës së lartë që drejtonte ekonominë
- 29.** Si ndikoj përhapja e fesë islame në mesin e fiseve arabe?
- Në dobësimin e unitetit politik
 - Në zhvillimin e politeizmit
 - Në zhdukjen e monoteizmit
 - Në forcimin e unitetit politik

- 30.** Si quheshin organizatat mesjetare të tregtarëve?
A. Komuna
B. Gilde
C. Esnafe
D. Kallfe
- 31.** Princi Karl Topia në dokumentet e kohës është quajtur me titullin:
A. Zot i gjithë vendit të Arbrit
B. Zot i gjithë vendit të Shqipërisë
C. Sundimtar i gjithë vendit të Ilirisë
D. Sundimtarë i gjithë vendit të Epirit
- 32.** Durrësi ishte kryeqendra e Mbretërisë Ilire të:
A. Dardanëve
B. Molosëve
C. Taulantëve
D. Ardianëve
- 33.** Janë dhënë pohimet:
I. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: sllovenët, kroatët, serbët, malazezët, maqedonët dhe bullgarët
II. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: çekët, sllovakët dhe polakët
III. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: rusët, bjellorusët dhe ukrainasit
IV. Pasardhës të Sllavëve të jugut janë: rusët, polakët dhe ukrainasit
- Cilat nga pohimet e dhëna është i saktë?
A. Pohimi nën I
B. Pohimi nën II
C. Pohimi nën III
D. Pohimi nën IV
- 34.** Në pashallëkun e Janinës pos shqiptarëve si një grup i madh etnik jetonte edhe cili popull tjetër:
A. Populli bullgar
B. Populli grek
C. Bashkësia etnike serbe
D. Bashkësia etnike malazeze
- 35.** Në dhjetor-janar të 1943-1944 Lëvizja Nacionalçlirimtare e Kosovës organizoi një mbledhje në të cilën kërkohet bashkimi i viseve të banuara me shqiptarë me shtetin amë. Për vendimet e cilit tubim bëhet fjalë:
A. Lidhjen e Pejës
B. Lidhjen e dytë të Prizrenit
C. Konferencën e Bujanit
D. Kuvendi i Junikut

SOCIOLOGJI

- 36.** Sipas cilit mendimtar, revolucioni shërben si forcë lëvizëse për shembjen e sistemit shoqëror ?
- A. Zh. Ruso
 - B. E. Dyrkemi
 - C. S. Simoni
 - D. K. Marksi
- 37.** Përkufizimi: “ *Sociologjia është shkencë, në kuptimin që ajo nënkupton metodat sistematike të studimit dhe vlerësimin e teorive nën dritën e fakteve dhe argumentimit logjik* ” është:
- A. i pranueshëm dhe i njëanshëm
 - B. i plotë dhe i pjesërishëm
 - C. i pranueshëm dhe i plotë
 - D. i pranueshëm dhe i pjesërishëm
- 38.** Sipas *Platonit* shtetin duhet ta mbrojnë:
- A. Rojtarët
 - B. Filozofët
 - C. Zanatçinjtë
 - D. Robërit
- 39.** Ideologjia radikale për dallim nga ajo konservatore mbështetet në:
- A. vlerat e ruajtjes
 - B. vlera stabile
 - C. vlerat djathtiste
 - D. vlerat e ndryshimit
- 40.** Cila teori bënë interpretimin e kompleksitetit të kulturës përmes fakteve ?
- A. teoria metafizike
 - B. teoria pozitiviste
 - C. teoria kulturaliste
 - D. teoria natyraliste
- 41.** Kombi është:
- A. Bashkësi e madhe njerëzish
 - B. Bashkësi e madhe popujsh
 - C. Bashkësi e vogël fisesh
 - D. Bashkësi klasash
- 42.** Fe monoteiste është:
- A. budizmi
 - B. hinduizmi
 - C. islamizmi
 - D. konfuçianizmi

- 43.** Burokracia paraqet :
- A. shtresën shoqërore të nëpunësve
 - B. elitën intelektuale në një shoqërie
 - C. elitën artistike në një shoqëri
 - D. kastën e privilegjuar në një shoqëri
- 44.** Dinamika dhe statika sociale studiohen nga:
- A. antropologjia
 - B. psikologjia
 - C. sociologjia
 - D. filozofia
- 45.** Martesa zakonore lidhet sipas normave:
- A. religjioze
 - B. shtetërore
 - C. moderne
 - D. tradicionale
- 46.** Në demokraci dominon:
- A. pushteti i oligarkisë
 - B. pushteti i shumicës
 - C. pushteti i pakicës
 - D. pushteti i meritokracisë
- 47.** Teoria mekaniciste pikënisje ka metodat e shkencave natyrore dhe:
- A. emocionalen
 - B. shoqëroren
 - C. ligjshmëritë
 - D. psikikën
- 48.** Shoqëria pasindustriale karakterizohet me punë:
- A. bujqësore
 - B. teknologjike
 - C. industriale
 - D. fizike
- 49.** Pushteti politik kërkesën për dëgjueshmëri e bazon në legjimitet, këtë teori e përfaqëson:
- A. Maks Veberi
 - B. Shën Augustini
 - C. Tomas Kompanella
 - D. Herber Spenseri
- 50.** Determinizimi shpjegohet:
- A. parashikimi i dukurive të ardhme socio-kulturore
 - B. mosvarësia e një dukurie nga dukuria tjetër
 - C. moslidhmëria e shkencave shoqërore me ato natyrore
 - D. çdo dukuri duhet të jet e përcaktuar në raport me një dukuri tjetër

- 51.** Komunikimi si forma më efikase në shkallë të lartë përdorimi, quhet gjuhë :
- A. zhargonesh
 - B. eklektizëmi
 - C. standarde
 - D. mobiliteti
- 52.** Diktatura paraqet:
- A. formë të qeverisjes
 - B. qeverisjen humane
 - C. traditën e pushtetit
 - D. kulturën e shoqërisë
- 53.** Shteti duhet të ketë:
- A. territorin, ekonominë, kulturën
 - B. pushtetin, ekonominë, filozofinë
 - C. ideologjinë, ekosistemin, territorin
 - D. territorin, popullsinë, pushtetin publik
- 54.** Cili ishte botëkuptimi shkencor i Ogyst Kontit ?
- A. Iluminizmi
 - B. Pozitivizmi
 - C. Revolucionimi
 - D. Strukturalizmi
- 55.** E drejta është sistem i rregullave dhe normave të cilat i nxjerrë:
- A. bashkësia
 - B. tradita
 - C. familja
 - D. shteti
- 56.** Forma e pabarazisë shoqërore, të grupet e njerëzve me pasuri ekonomike, që ndikon në mënyrën e tyre të jetës është:
- A. klasa
 - B. kasta
 - C. skllavëria
 - D. shtresa
- 57.** Religjionet emocionale nënkuptojnë avancimin e:
- A. të drejtës dhe zakoneve
 - B. ndjenjave dhe të moralitetit
 - C. të drejtës juridike dhe politike
 - D. të drejtës individuale

- 58.** Normat juridike :
- A. dallojnë nga ato fetare dhe morale
 - B. janë të njëjta me ato fetare dhe morale
 - C. krijohen nga bashkësitë fetare
 - D. krijohen nga bashkësitë zakonore
- 59.** Kush është themelues i teorisë formale të sociologjisë ?
- A. Park
 - B. Sorkin
 - C. Spenser
 - D. Zimel
- 60.** Në kulturën nacionale, nënsistemet e veçanta njihen si:
- A. makrokultura
 - B. etno-kultura
 - C. subkultura
 - D. maskultura

GJUHË E DYTË E HUAJ

(Zgjedhni vetëm njëren nga gjuhët:

Gjuha Gjermane apo Gjuha Frenge)

GJUHA GJERMANE

61. Guten Abend, ich _____ Jürgen.
A. ist
B. heisst
C. komme
D. heisse
62. Frau Krasniqi, _____ Sie aus Albanien?
A. seid
B. kommen
C. kommt
D. heissen
63. Ich _____ Französisch.
A. spreche
B. sprichst
C. bist
D. sprechen
64. Das sind Ana und Artta. _____ sind noch Schülerinnen.
A. Die
B. Diese
C. Sie
D. Und
65. _____ kommen Sie Herr Paskal?
A. wie
B. wer
C. was
D. woher
66. Das ist doch _____ Apfel. Das ist eine Tomate.
A. nicht
B. nein
C. kein
D. nichts

- 67.** Ich nehme einen Apfelsaft. Was _____ du?
A. möchte
B. möchtest
C. möchtet
D. möchten
- 68.** Arbeiten Sie hier _____ lange? Nein, erst fünf Tage.
A. schon
B. erst
C. noch
D. jetzt
- 69.** Der Couch ist doch nicht klein! _____ ist groß.
A. Sie
B. es
C. er
D. das
- 70.** Ist unsere neue Wohnung zu hell? Nein, sie ist sehr _____.
A. groß
B. neu
C. billig
D. dunkel
- 71.** Ich trinke eine Cola. Und was _____ ?
A. du
B. nimmst du
C. hast du
D. sagst du
- 72.** Paul hat sich in eine hübsche Dänin ____ liebt.
A. be-
B. auf-
C. ein-
D. ver-
- 73.** Das Jurastudium hat mir nicht _____.
A. gefiel
B. gefällt
C. gefallen
D. gefällt

74. Wann ist die Arztpraxis geöffnet? _____ 8 Uhr 30 _____ 16Uhr 30.
A. Um...am
B. Von... bis
C. Bis... von
D. Am ... um

75. Wir _____ im Muenchens bekannten Englischen Garten spazieren _____.
A. haben ... gehen
B. seid ... gewesen
C. sind ... gegangen
D. haben ... gewesen

76. Ordnen Sie den Satz:

Hausaufgaben - machen- nicht - ich - ! - heute- meine - will

Welcher Satz ist richtig

- A. Heute will ich meine Hausaufgaben nicht machen!
B. Ich heute will meine Hausaufgaben nicht machen!
C. Meine Hausaufgaben nicht machen will ich heute!
D. Heute will ich nicht machen meine Hausaufgaben!
77. Welche Antwort past?
Guten Tag, Herr Müller! Wie geht es Ihnen?

- A. Ein schöner Tag heute!
B. Danke schön, Ihnen auch!
C. Gut, danke. Und Ihnen?
D. Freut mich Sie zu sehen!

78. Welche Wörter passen?

Unser Garten ist _____ euer!
A. lieber als
B. größer als
C. am größten
D. so groß

79. *Lesen Sie den Text und kreuzen Sie die richtige Antwort auf dem Antwortblatt*

Liebe Claudia, lieber Gabriel,

Vielen Dank fuer die Einladung zur Silvesterparty. Mathias und ich koennen leider nicht kommen, den unsere Eltern besuchen uns Silvester. Ich wuensche euch noch frohe Weihnachten, eine schoene Feier und ein frohes neues Jahr! Wir sehen uns dann im Januar. Habt ihr am neunten Januar Zeit? Da wollen wir meinen Geburtstag feiern. Ich wuerde mich freuen, wenn ihr kommt!

Viele Grüße auch von Mathias.

Eure Nina

Claudia und Gabriel sollen zu Nina und Mathias kommen:

- A. Zur Silvesterparty
- B. Deren Eltern zu besuchen
- C. Weihnachten feiern
- D. Ninas Geburtstag feiern

80. *Lesen Sie bitte den folgenden Text und wählen Sie die richtige Antwort aus.*

Nach einer Niederlage gegen Freiburg am letzten Wochenende gewann der VfB Stuttgart gestern vor 25 000 Zuschauern mit 2:1 gegen den Hamburger SV. Die Gäste aus Hamburg schossen in der 15. Minute durch Horst Hrubesch das 0:1. In der zweiten Halbzeit glich Spielmacher Martin Oettel für Stuttgart aus, und in der 75. Minute schoss der gleiche Spieler das verdiente 2:1.

Wo fand das Spiel statt?

- A. In Hamburg
- B. In Stuttgart
- C. In München
- D. In Freiburg

GJUHA FRENGE

- 61.** La forme correcte au présent est:
- A. Je habite à Paris
 - B. Je habites à Paris
 - C. J’habit à Paris
 - D. J’habite à Paris
- 62.** Quel est le temps de “Si j’étais président,...”
- A. Le passé simple
 - B. L’imparfait
 - C. Le plus-que-parfait
 - D. Le futur simple
- 63.** Quel est le mot différent ici?
- A. Pain
 - B. Chaud
 - C. Bon
 - D. Blanc
- 64.** Le mot “tente” ne rime pas avec:
- A. Lente
 - B. Tante
 - C. Peinte
 - D. Vente
- 65.** La Fête nationale française est le 14 juillet:
- A. Quinze juillet
 - B. Quatre juillet
 - C. Quarante juillet
 - D. Quatorze juillet
- 66.** Quand tu quittes un ami, tu dis:
- A. Ça va?
 - B. Bonjour!
 - C. Au revoir!
 - D. Merci!
- 67.** Pour exprimer ta douleur, tu dis:
- A. Je suis fatigué
 - B. Je suis triste
 - C. Je suis content
 - D. Je suis joyeux
- 68.** Si tu aimes les glaces, tu dis:
- A. J’adore les glaces
 - B. Je déteste les glaces
 - C. Je préfère les glaces
 - D. Je ne mange jamais de glace

- 69.** Le synonyme de “Le roi”:
- A. Le président
 - B. Le chef de l'état
 - C. Le Monarque
 - D. Le premier ministre
- 70.** “Eminem est le plus grand chanteur de rap” veut dire:
- A. Eminem chante mal
 - B. Eminem est moyen
 - C. Eminem n'est pas une star de la musique
 - D. Eminem est le meilleur chanteur de rap
- 71.** “J'aimerais que tu viennes avec moi” exprime:
- A. La volonté
 - B. Le désir
 - C. La nécessité
 - D. La crainte
- 72.** Complétez ce texte par le mot manquant:
La jeune femme litd'amour. Elle aime ce genre de livres.
- A. une lettre
 - B. une phrase
 - C. un texte
 - D. un roman
- 73.** l'antonyme de la belle fille :
- A. la belle demoiselle
 - B. la vieille dame
 - C. la fille laide
 - D. la jolie fille
- 74.** ma maison est grande, ma est :
- A. un pronom démonstratif
 - B. un adjectif possessif
 - C. un adjectif démonstratif
 - D. un pronom personnel
- 75.** L'un des adjectifs suivants n'a pas sa place ici :
- A. Jaune
 - B. Rouge
 - C. Jeune
 - D. Vert
- 76.** Le français a deux auxiliaires : avoir et...
- A. être
 - B. a été
 - C. avoir été
 - D. avoir eu

77. le masculin de sœur est :

- A. père
- B. frère
- C. cousin
- D. frangine

78. Pour acheter des billets de train, il faut aller à :

- A. à la gare
- B. à la cave
- C. à la bibliothèque
- D. au marché

79. Le hit français est :

- A. Papa, Maman, écoutez
- B. Papa, Maman, désolé
- C. Papa, Maman , pardonnez
- D. Papa, Maman, excusez

80. 1ère personne du singulier, auxiliaire avoir, ind. Présent :

- A. J'aurai
- B. J'avais
- C. J'ai
- D. J'ai eu